



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2019

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 17.06.2019)*

**Pika 1 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi fillimin e procedurës së transferimit të përkohshëm dhe shpalljen e një pozicioni të lirë për transferim të përkohshëm në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

***Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Maksim Qoku.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 14:13 dhe mbaroi në orën 15:55.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                            |                          |
|----------------------------|--------------------------|
| <b>1. Maksim Qoku</b>      | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>2. Medi Bici</b>        | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>3. Fatmira Luli</b>     | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>4. Brunilda Kadi</b>    | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Ilir Toska</b>       | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>6. Alban Toro</b>       | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Brikena Ukperaj</b>  | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>8. Erjon Muharremaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>9. Marçela Shehu</b>    | <b>(anëtare)</b>         |

*Shënim:* Nuk mori pjesë në mbledhje *zonja Naureda Llagami*, Kryetare e Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe *zoti Dritan Hallunaj*, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë institucionit.*
- 4. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë institucionit.*
- 5. Elis Kuçi, Specialist pranë institucionit.*
- 6. Valbona Bako, Specialiste pranë institucionit.*
- 7. Edlira Bako, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 8. Migena Kondo, Komiteti Shqiptar i Helsinkit.*
- 9. Klara Kodra, Qendra Evropiane.*
- 10. Gregor Borgowski, EURALIUS.*
- 11. Klodian Rado, EURALIUS.*
- 12. Erion Fejzulla, USAID.*
- 13. Marjana Papa, OSCE.*

#### **RENDI I DITËS:**

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi fillimin e procedurës së transferimit të përkohshëm dhe shpalljen e një pozicioni të lirë për transferim të përkohshëm në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës, për gatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

*Maksim Qoku:* Atëherë, përshëndetje të nderuar anëtarë!

Vijojmë me mbledhjen e ditës së sotme.

Përsëri kjo mbledhje do të drejtohet nga unë për sa Kryetarja e institucionit mbetet e angazhuar në disa detyra jashtë shtetit, për efekt të nenit 60 të ligjit 115 për

qeverisjen dhe në kuadër të kësaj, verifikojmë edhe në bazë të nenit 68 të po këtij ligji, kuorumin, duke qenë që mungojnë dy anëtarë, Kryetarja dhe anëtari Dritan Hallunaj, por meqë numri është mbi 7, kuorumi është i mundshëm, operojmë me axhendën e ditës.

***Brikena Ukperaj:*** Zoti Zëvendëskryetar, më fal!

Duhet të përmendim për zotin Hallunaj mungon për shkak se ndodhet në shortet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

***Maksim Qoku:*** Okej!

Kemi një axhendë me 8 çështje. Është nevoja t'i lexojmë apo të identifikohen?

Çështja e parë është: Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi fillimin e procedurës së transferimit të përkohshëm dhe shpalljen e një pozicioni të lirë për transferim të përkohshëm në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Bashkëlidhur është edhe projektvendimi dhe relacioni.

Çështja e dytë është: Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi fillimin e procedurës së transferimit të përkohshëm dhe shpalljen e një pozicioni të lirë për transferim të përkohshëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës, përgatitur po nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Çështja e tretë: Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi fillimin e procedurës së transferimit të përkohshëm dhe shpalljen e dy pozicioneve të lira për transferim të përkohshëm në Gjykatën e Rrethit Kavajë, përgatitur po nga i njëjti Komision i Zhvillimit të Karrierës.

Çështja e katërt është: Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi shfuqizimin e vendimit nr. 60, datë 24.04.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për fillimin e procedurës së transferimit të përkohshëm dhe shpalljen e një pozicioni të lirë të përkohshëm për transferim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Çështja e pestë: Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi fillimin e procedurës së transferimit të përkohshëm dhe shpalljen e një pozicioni të lirë për transferim të përkohshëm në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, përgatitur nga Zhvillimi i Karrierës.

Çështja e gjashtë: Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi shfuqizimin e vendimit nr. 61, datë 24.04.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për fillimin e procedurës së transferimit të përkohshëm dhe shpalljen e një pozicioni të lirë të përkohshëm për transferim në Gjykatën Rrethit Gjyqësor Kurbin”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Çështja e shtatë: Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi fillimin e procedurës së transferimit të përkohshëm dhe shpalljen e një pozicioni të lirë për transferim të përkohshëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Çështja e tetë dhe e fundit: Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme” i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Kështu që, në respektim të rendit të ditës, procedojmë me çështjen e parë. Nëse do ta relatoni ju zoti Toska? Fjala është për ju!

**Ilir Toska:** Këtë çështjen e parë të rendit të ditës e ka si relator anëtari i Komisionit, Alban Toro. Është ai që do ta relatojë.

**Maksim Qoku:** Fjala është për ju, zoti Toro!

**Alban Toro:** Faleminderit!

Më parë, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me vendimin 47, 13.06.2018 “Mbi transferimin e përkohshëm të gjyqtarëve në disa gjykata” ka disponuar për gjyqtaren {...}, të cilën e ka transferuar përkohësisht me një afat 1-vjeçar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës, duke konstatuar që kjo gjykatë kishte nevojë të ngutshme për caktimin e 1 gjyqtari. Kuptohet që në kuptim të gjykatës caktuar me ligj dhe të faktit që aktualisht ky afat tashmë ka kaluar, pra i bie 13.06.2019, nga ana e Komisionit është bërë një vlerësim i ngarkesës aktuale të kësaj gjykate, por njëkohësisht edhe të gjykatës nga e cila ka ardhur gjyqtarja {...}.

Aktualisht gjendja paraqitet e fotografuar në momentin 13 qershor 2019 nga stafi i Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe është ky: Gjyqtarja {...} ka 65 çështje në gjykim; Gjyqtarja {...} - 433 çështje në gjykim; Gjyqtari {...} - 437 çështje në gjykim dhe;

Gjyqtarja për të cilën ne propozojmë, për të cilën ne kemi propozim më pas është {...} me 269 çështje në gjykim.

Aktualisht, në bazë të Dekretit 7818, 16.11.2012, organika e Gjykatës Administrative e Shkallës së Parë Durrës është me 4 (katër) gjyqtarë, ku në mënyrë të përhershme, janë të emëruar 3 (tre) gjyqtarë.

Duke u bazuar në të dhënat e paraqitura, Komisioni vlerëson se nevojat e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës për sa i përket, duke marrë në raport edhe ngarkesën e punës, nuk plotësohen me skemën e delegimit, por njëkohësisht nuk mund të plotësohen as nëpërmjet caktimit të gjyqtarit për çështje të veçanta, pasi siç konstatuam, numri i çështjeve është relativisht i lartë.

Në këto kushte, Komisioni vlerëson se në rastin konkret, për plotësimin e nevojave të evidentuara të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, Këshilli duhet të orientohet në përcaktimet e vendimit nr. 23, 07.02.2019, “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit”, me ndryshimet përkatëse.

Bazuar në të dhënat e paraqitura, si dhe referuar vendimit të KLGJ-së nr. 23, datë 07.02.2019, pra të Rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm, Komisioni vlerëson se Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës është “gjykatë në nevojë”. Përcaktimin e gjykatës në nevojë e jep Neni 3 i kësaj Rregulloreje e cila nënkupton gjykatën në të cilën ka një ose disa pozicione të lira të përkohshme, situatë e cila cenon funksionimin normal të saj.

Natyrisht, duke parë dobinë, duke pasur parasysh raportin midis dobisë dhe efektet negative që sjell transferimi i kësaj gjyqtareje në atë gjykatë, pra me transferimin e një gjyqtari të ri në këtë gjykatë, është konstatuar që dobia është me madhe në raport me efektin negativ që shkakton mos dërgimi i saj/i një gjyqtari në këtë gjykatë.

Për rrjedhim, është menduar dhe i propozohet Këshillit të Lartë Gjyqësor, të shpallet 1 pozicion i lirë, gjithmonë nën dritën e Rregullores dhe ndryshimit të Rregullores për transferimin e përkohshëm të gjyqtarëve, është propozuar të shpallet 1 pozicion i lirë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës për transferim të përkohshëm deri në 1 vit. Thirrja për transferim t’i drejtohet gjyqtarit të transferuar

aktualisht në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës, i cila të ftohet për të dhënë pëlqimin për përsëritjen e transferimit të përkohshëm. Afati për dhënien e pëlqimit për transferim të përkohshëm të jetë 3 ditë, duke filluar nga dita e publikimit të thirrjes në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Kuptohet që do të ngarkohet Komisioni i Zhvillimit të Karrierës për të ndjekur hapat e mëtejshëm, në rast se nuk do të ketë një reagim nga ana e gjyqtarëve për të dhënë pëlqimin për këtë transferim të përkohshëm. Faleminderit!

**Maksim Qoku:** Faleminderit, zoti Toro!

Fjala është për anëtarët nëse ka dikush diskutim apo mendim.

Nëse s'keni, kalojmë në proces votimi?

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Illir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Maksim Qoku:** Dakord.

\* \* \*

(Pika 1 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2019

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 17.06.2019)*

**Pika 2 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi fillimin e procedurës së transferimit të përkohshëm dhe shpalljen e një pozicioni të lirë për transferim të përkohshëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

***Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Maksim Qoku.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 14:13 dhe mbaroi në orën 15:55.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                            |                          |
|----------------------------|--------------------------|
| <b>1. Maksim Qoku</b>      | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>2. Medi Bici</b>        | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>3. Fatmira Luli</b>     | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>4. Brunilda Kadi</b>    | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Ilir Toska</b>       | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>6. Alban Toro</b>       | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Brikena Ukperaj</b>  | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>8. Erjon Muharremaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>9. Marçela Shehu</b>    | <b>(anëtare)</b>         |

*Shënim:* Nuk mori pjesë në mbledhje *zonja Naureda Llagami*, Kryetare e Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe *zoti Dritan Hallunaj*, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë institucionit.*
- 4. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë institucionit.*
- 5. Elis Kuçi, Specialist pranë institucionit.*
- 6. Valbona Bako, Specialiste pranë institucionit.*
- 7. Edlira Bako, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 8. Migena Kondo, Komiteti Shqiptar i Helsinkit.*
- 9. Klara Kodra, Qendra Evropiane.*
- 10. Gregor Borgowski, EURALIUS.*
- 11. Klodian Rado, EURALIUS.*
- 12. Erion Fejzulla, USAID.*
- 13. Marjana Papa, OSCE.*

#### **RENDI I DITËS:**

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi fillimin e procedurës së transferimit të përkohshëm dhe shpalljen e një pozicioni të lirë për transferim të përkohshëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

*Maksim Qoku:* Operojmë me çështjen e dytë të rendit të ditës.

Kush nga anëtarët e Komisionit është relator?

*Ilir Toska:* Është përsëri zoti Toro.

*Maksim Qoku:* Fjala për ju, zoti Toro!

*Alban Toro:* Faleminderit!



E njëjta procedurë edhe për çështjen e transferimit të përkohshëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës. Me një vendim të mëparshëm nr. 47, 13.06.2018, ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka disponuar për gjyqtarin {...}, i cili aktualisht është gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat, por është transferuar përkohësisht për 1 vit nga hyrja e këtij vendimi në fuqi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës.

Natyrisht, duke marrë në konsideratë kuptimin e gjykatës të caktuar me ligj si dhe faktin që aktualisht ky afat është tejkaluar pasi më datë 13.06.2019 mbaron transferimi i këtij gjyqtari, është rivlerësuar nga ana e Komisionit të ngarkesës së kësaj gjykate të shpërndarë përkatësisht midis gjyqtarëve {...}, {...} dhe {...}. Çështje të cilët ata kanë në gjykim janë përkatësisht: 56, 70 dhe 60.

Rezulton sipas Dekretit 7818, 16.11.2012 se organika e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës është 4 (katër) gjyqtarë, ku në mënyrë të përhershme janë emëruar 2, zoti {...} dhe zonja {...}, ndërsa ka edhe një gjyqtar, {...} që është i transferuar përkatësisht në bazë të vendimit të KLD-së nr. 47, 13.06.2018.

Natyrisht, duke parë që nevojat e Gjykatës së Rrethit Kukës nuk mund të plotësohen përmes skemës së delegimit as në bazë të Rregullores për caktimin e gjyqtarëve për çështje gjyqësore të veçanta, është menduar që të vazhdohet të aplikohet vendimi 23, 07.02.2019 “Mbi miratimin e Rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit”, kuptohet, me ndryshimet përkatëse.

Bazuar në të dhënat e paraqitura dhe referuar vendimit të KLGJ-së, nr. 23, datë 07.02.2019, nga ku deduktohet në Nenin 3 kuptimi i “Gjykatës në nevojë” që nënkupton gjykatën në të cilën ka një ose disa pozicione të lira të përkohshme, situatë e cila cenon funksionin normal të saj, natyrisht duke vlerësuar edhe ndikimin negativ që do të kishte raporti midis dërgimit të një gjyqtari nga kjo gjykatë apo dërgimin në atë gjykatë ku ai është caktuar në mënyrë të përhershme, është vlerësuar që përsëri të operohet me të njëjtën Rregullore, duke bërë transferimin e përkohshëm të një gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Kukës.

Nënkryetar dritën/optikën e ndryshimeve të kësaj Rregulloreje është propozuar e njëjta skemë. Të shpallë 1 pozicion të lirë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës për transferimin e përkohshëm deri më datë 15.09.2019, pra në rastin konkret kemi

përcaktuar një afat për transferim më të vogël se sa në rastin e parë. Thirrja për transferim t'i drejtohet gjyqtarit të transferuar aktualisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës, i cili ftohet për të dhënë pëlqimin për përsëritjen e transferimit të përkohshëm. Afati për dhënien e pëlqimit për transferim të përkohshëm të jetë 3 ditë, duke filluar nga dita e publikimit të thirrjes në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Kuptohet që ecuria e mëtejshme do t'i ngarkohet këtij Komisioni për të vazhduar procedurën e mëtejshme, duke parë edhe reagimin e gjyqtarëve në dhënien e pëlqimit.

**Maksim Qoku:** Faleminderit, zoti Toro!

Ju lutem anëtarëve nëse keni...?

Po, zoti Bici!

**Medi Bici:** Kisha unë, për pikën 1 të vendimit. Them që afati duhet të jetë edhe këtu deri në 1 vit. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat më rezulton vetëm me 119 çështje dhe 3 gjyqtarë janë më se të mjaftueshëm për këtë. Kurse Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës ka dyfishin e saj.

Do të isha që edhe këtu të ishte deri në 1 vit. Pse do mblidhemi pas 1 muaji prapë?!

**Maksim Qoku:** Faleminderit, zoti Bici!

Fjala për ju, zoti Toska!

**Ilir Toska:** Është menduar deri më datë 15 shtator me idenë se ne shumë shpejt duhet të bëjmë emërimin e magjistratëve të rinj. Gjyqtari {...} është në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat dhe do duhet të rikthehet përsëri në gjykatën ku është. Kemi menduar që të jetë deri më 15 shtator afati, nëse jep pëlqimin, me idenë që të ezaurojë çështjet që ka në dorë. Tashmë, sipas informacionit që kemi, ka rreth 60 çështje në dorë dhe më tej do duhet të konsiderojmë një mënyrë tjetër për plotësimin e nevojave të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, pra siç është emërimi në mënyrë të përhershme i një gjyqtari. Kjo është arsyeja.

**Maksim Qoku:** Faleminderit, zoti Toska!

Arsyetime të tjera?

Unë në fakt vetëm diçka kisha. Natyrisht ne jemi në fakt për emërimin e magjistratëve të rinj, por duke gjykuar që në Kukës nuk ka dalë në veting kryetari dhe

mbase mund të krijohet ndonjë problem në aspektin e diskordancës midis daljes në veting në proces dhe mbase një rezultati negativ dhe emërimit të magjistratëve, mund të na krijohet prapë nevoja që do duhet të mblidhemi dhe prandaj edhe do ta gjykoja edhe këtu afatin deri në 1 vit, ndërkohë që ne edhe mund ta ndërpresim, siç bëjmë me rastin e atij të Tropojës. Gjithsesi, ky është mendimi im.

**Ilir Toska:** Atëherë, mund të jetë edhe një arsye tjetër sepse ne duhet të bëjmë një emërim të përkohshëm. Mundet që nëse ndodh situata që ju supozoni, të konsiderojmë përsëri një transferim, qoftë edhe të gjyqtarit {...} apo të një gjyqtari tjetër. Për momentin, kemi fotografuar këtë gjendje që është sot. Nuk e di në të ardhmen se si do të jetë gjendja.

**Medi Bici:** Varianti që them unë, nuk na pengon ne që me 15 shtator të bëjmë ndërprerjen e këtij. Deri në 1 vit.

**Maksim Qoku:** Okej! Në qoftë se s'ka diskutime kalojmë në proces votimi.

(Çfarë do hidhet në votim, -pyet një nga anëtarët pa ndezur mikrofonin.)

**Maksim Qoku:** Tani do hedhim këtë “deri në 1 vit”.

Pra kalojmë tek votimi i propozimit “deri në 1 vit”, të zotit Medi Bici.

**Brunilda Kadi:** Kundër.

**Ilir Toska:** Kundër.

**Alban Toro:** Kundër.

**Fatmira Luli:** Kundër.

**Marçela Shehu:** Kundër.

**Erjon Muharremaj:** Kundër.

**Brikena Ukperaj:** Kundër.

**Medi Bici:** Pro.

**Maksim Qoku:** Pro.

Kalojmë në votimin e projekt-aktit.

**Brunilda Kadi:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Pro.

*Marçela Shehu*: Dakord.

*Erjon Muharremaj*: Pro.

*Brikena Ukperaj*: Pro.

*Medi Bici*: Kundër.

*Maksim Qoku*: Kundër.

Pra mbaruam me çështjen e dytë të rendit të ditës.

\* \* \*

(Pika 2 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2019

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 17.06.2019)*

**Pika 3 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi fillimin e procedurës së transferimit të përkohshëm dhe shpalljen e dy pozicioneve të lira për transferim të përkohshëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

***Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Maksim Qoku.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 14:13 dhe mbaroi në orën 15:55.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
2. ***Medi Bici*** (anëtar)
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
5. ***Illir Toska*** (anëtar)
6. ***Alban Toro*** (anëtar)
7. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
8. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)
9. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

*Shënim:* Nuk mori pjesë në mbledhje *zonja Naureda Llagami*, Kryetare e Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe *zoti Dritan Hallunaj*, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë institucionit.*
- 4. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë institucionit.*
- 5. Elis Kuçi, Specialist pranë institucionit.*
- 6. Valbona Bako, Specialiste pranë institucionit.*
- 7. Edlira Bako, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 8. Migena Kondo, Komiteti Shqiptar i Helsinkit.*
- 9. Klara Kodra, Qendra Evropiane.*
- 10. Gregor Borgowski, EURALIUS.*
- 11. Klodian Rado, EURALIUS.*
- 12. Erion Fejzulla, USAID.*
- 13. Marjana Papa, OSCE.*

#### **RENDI I DITËS:**

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi fillimin e procedurës së transferimit të përkohshëm dhe shpalljen e dy pozicioneve të lira për transferim të përkohshëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

*Maksim Qoku:* Kalojmë tek pika 3. Shqyrtimi i dry projektvendimeve.

Zoti Toska, kush do e relatojë?

*Ilir Toska:* Për çështjen e tretë është relator anëtari Alban Toro.

*Maksim Qoku:* Zoti Toro, fjala për ju!

**Alban Toro:** I referohemi përsëri vendimit nr. 47, 13.06.2018, mbi transferimin e përkohshëm të gjyqtarëve në disa gjykata, të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i cili më herët ka transferuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë gjyqtarët {...}, i cili vjen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë dhe zonjën/gjyqtaren {...} që vjen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat.

Në kuptim të gjykatës të caktuar me ligj dhe të faktit që ky afat 1-vjeçar tashmë ka kaluar, pra i takonte të mbaronte më datë 13.06.2019, nga ana e Komisionit është bërë një vlerësim i ngarkesës, siç paraqitet gjendja aktuale e ngarkesës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë e cila paraqitet përkatësisht si më poshtë: Gjyqtare {...} – 118 çështje në gjykim; Gjyqtar {...} – 97 çështje në gjykim; Gjyqtar {...} – 145 çështje në gjykim dhe; Gjyqtare {...} – 126 çështje në gjykim.

Sipas Dekretit 7818, 16.11.2012 organika e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë është me 4 (katër) gjyqtarë, ku në mënyrë të përhershme janë 2, zoti {...} dhe zonja {...}. Ndërsa ka edhe 2 gjyqtarë, zonjën {...} dhe {...}, të transferuar – siç thamë më herët – me vendimin 47, datë 13.06.2018 të ish-KLD-së.

Duke u bazuar në të dhënat e fotografuara në këtë ditë, Komisioni vlerëson se nevojat e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë nuk mund të plotësohen përmes skemës së delegimit, por gjithashtu nuk mund të procedohet as me Rregulloren e përcaktimit të gjyqtarëve për çështje të veçanta, sipas vendimit të KLGJ-së nr. 30, datë 14.09.2019 (*lapsus, pasi është 14.02.2019*).

Në këto kushte, Komisioni vlerëson se, në rastin konkret, për plotësimin e nevojave të evidentuara të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, Këshilli duhet të orientohet në përcaktimet e vendimit 23, 07.02.2019 “Mbi miratimin e Rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit”, me ndryshime, duke shpallur 2 (dy) pozicione të lira për transferimin e përkohshëm pranë kësaj gjykate.

Kuptohet që për të arritur në këtë konkluzion nga ana jonë, pra për të vijuar aplikimin e kësaj Rregulloreje është fotografuar edhe gjendja aktuale e dy gjykatave nga vijnë gjyqtarët, përkatësisht ajo e Beratit dhe e Korçës dhe është konstatuar që efektet janë më tepër pozitive po të vazhdojmë të procedojmë me transferimin e gjyqtarëve në

këtë gjykatë, se sa efekti negativ, pra që t'i kthejmë përsëri në vendin e tyre të mëparshëm të punës.

Kështu që, në këtë kuadër, i propozojmë Këshillit të Lartë Gjyqësor të shpallë 2 (dy) pozicione të lira në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë për transferimin e përkohshëm deri në 1 vit. Thirrja t'i drejtohet gjyqtarëve të transferuar aktualisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, të cilët ftohen për të dhënë pëlqimin për përsëritjen e transferimit të përkohshëm. Afati për dhënien e pëlqimit për transferim të përkohshëm të jetë 3 ditë, duke filluar nga dita e publikimit të thirrjes në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Në fund, gjithmonë, ngarkohet Komisioni i Zhvillimit të Karrierës për ndjekjen e hapave të mëtejshëm të procedurës së transferimit të përkohshëm.

**Maksim Qoku:** Faleminderit, zoti Toro!

Ju lutem anëtarëve nëse kemi diskutime. Fjala për ju!

Nuk ka diskutime. Vazhdojmë procesin e votimit.

**Brunilda Kadi:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

(Vota e zotit Bici nuk dëgjohet.)

**Maksim Qoku:** Dakord.

\* \* \*

(Pika 3 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2019

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 17.06.2019)*

**Pika 4 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi shfuqizimin e vendimit nr. 60, datë 24.04.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për fillimin e procedurës së transferimit të përkohshëm dhe shpalljen e një pozicioni të lirë të përkohshëm për transferim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

***Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Maksim Qoku.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 14:13 dhe mbaroi në orën 15:55.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
2. ***Medi Bici*** (anëtar)
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
5. ***Ilir Toska*** (anëtar)
6. ***Alban Toro*** (anëtar)
7. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
8. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)
9. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

*Shënim:* Nuk mori pjesë në mbledhje *zonja Naureda Llagami*, Kryetare e Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe *zoti Dritan Hallunaj*, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë institucionit.*
- 4. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë institucionit.*
- 5. Elis Kuçi, Specialist pranë institucionit.*
- 6. Valbona Bako, Specialiste pranë institucionit.*
- 7. Edlira Bako, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 8. Migena Kondo, Komiteti Shqiptar i Helsinkit.*
- 9. Klara Kodra, Qendra Evropiane.*
- 10. Gregor Borgowski, EURALIUS.*
- 11. Klodian Rado, EURALIUS.*
- 12. Erion Fejzulla, USAID.*
- 13. Marjana Papa, OSCE.*

#### **RENDI I DITËS:**

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi shfuqizimin e vendimit nr. 60, datë 24.04.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për fillimin e procedurës së transferimit të përkohshëm dhe shpalljen e një pozicioni të lirë të përkohshëm për transferim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

*Maksim Qoku:* Atëherë, dalim në çështjen e katërt.

Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi shfuqizimin e vendimit nr. 60, datë 24.04.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për fillimin e procedurës së transferimit të përkohshëm dhe shpalljen e një pozicioni të lirë të përkohshëm për transferim në Gjykatën

Administrative të Shkallës së Parë Shkodër””, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Zoti Toska, kush është relatori?

**Ilir Toska:** Relatore është zonja Shehu.

**Maksim Qoku:** Fjala për ju, zonja Shehu!

**Marçela Shehu:** Faleminderit!

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, pas disa ndryshimeve që iu bënë Rregullores së transferimit, çmon se duhet t’i propozojë Këshillit të Lartë Gjyqësor një projektvendim për shfuqizimin e vendimit nr. 60, datë 24.04.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor për fillimin e procedurës së transferimit të përkohshëm dhe shpalljen e një pozicioni të lirë të përkohshëm për transferim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.

Ashtu siç e kemi cituar edhe në mbledhjen e datës 24.04.2019, nisur nga fakti se Gjykata Administrative të Shkallës së Parë Shkodër kishte një vend të lirë të përkohshëm dhe ishte në kushtet e cenimit të funksionimit normal të saj, Komisioni vlerësoi nisjen e procedurave për transferimin e përkohshëm të një gjyqtari në këtë gjykatë ku, mbi propozimin e tij, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin nr. 60, datë 24.04.2019, bazuar në nenin 46 të ligjit nr.96/2016 vendosi: të shpallë një pozicion të lirë të përkohshëm për transferim pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër; Të autorizojë Komisionin e Zhvillimit të Karrierës lidhur me këtë procedurë transferimi dhe; Të përcaktojë Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe gjykatat e rretheve gjyqësore Lezhë dhe Shkodër, si gjykata nga të cilat do të kryhet transferimi i përkohshëm i një gjyqtari për të gjykuar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.

Pas disa problematikave të konstatuara gjatë vijimit të procedurave të transferimit, bazuar edhe në opinionet ligjore të dy misionëve që asistojnë KLGJ-në, EURALIUS dhe USAID, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin nr. 86, datë 11.06.2019, “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 23, datë 07.02.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, miratoi disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren “Për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit”, shtesa dhe ndryshime këto që konsistojnë në përcaktimin më të qartë të nocioneve ligjore të adoptuara dhe në Rregullore, në zgjerimin

e rrethit të gjyqtarëve që ftohen për të dhënë pëlqim për transferim të përkohshëm, sikurse edhe në një qartësim të procedurave të transferimit të përkohshëm, si dhe në një prezencë të Këshillit në çdo fazë të këtyre procedurave përmes vendimmarrjeve të caktuara.

Në relacion janë paraqitur edhe disa nga ndryshimet kryesore, të cilat, besoj që nuk ka nevojë që t'i citoj.

Në këto kushte, pas miratimit të këtyre ndryshimeve nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Komisioni çmon se tashmë jemi në kushtet e rivlerësimit të vendimit nr. 60, datë 24.04.2019, “Mbi fillimin e procedurës së transferimit pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së parë Shkodër”, me të cilin Këshilli përcaktoi disa gjykata nga të cilat mund të kryhej procedura e transferimit, duke mos parashikuar marrjen e pëlqimit gjyqtarit që aktualisht është i transferuar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, nëse ekzistonin kushtet ligjore për zgjatjen e afatit të transferimit apo duke mos parashikuar kërkimin e pëlqimit nga të gjithë gjyqtarët që plotësojnë kriteret ligjore për këtë pozicion.

Bazuar në sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor: Të shfuqizojë vendimin nr. 60, datë 24.04.2019, “Mbi fillimin e procedurës së transferimit të përkohshëm dhe shpalljen e një pozicioni të lirë të përkohshëm për transferim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër”, si dhe të procedurave të ndjekura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës në zbatim të këtij vendimi.

***Maksim Qoku:*** Faleminderit, zonja Shehu!

Fjala për anëtarët, nëse kanë diskutime.

Atëherë, kalojmë në proces votimi?

***Brunilda Kadi:*** Pro.

***Ilir Toska:*** Dakord.

***Alban Toro:*** Dakord.

***Fatmira Luli:*** Pro.

***Marçela Shehu:*** Dakord.

***Erjon Muharremaj:*** Pro.

*Brikena Ukperaj*: Pro.

*Medi Bici*: Pro.

*Maksim Qoku*: Dakord.

\* \* \*

(Pika 4 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2019

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 17.06.2019)*

**Pika 5 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi fillimin e procedurës së transferimit të përkohshëm dhe shpalljen e një pozicioni të lirë për transferim të përkohshëm në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

***Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Maksim Qoku.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 14:13 dhe mbaroi në orën 15:55.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                            |                          |
|----------------------------|--------------------------|
| <b>1. Maksim Qoku</b>      | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>2. Medi Bici</b>        | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>3. Fatmira Luli</b>     | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>4. Brunilda Kadi</b>    | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Ilir Toska</b>       | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>6. Alban Toro</b>       | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Brikena Ukperaj</b>  | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>8. Erjon Muharremaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>9. Marçela Shehu</b>    | <b>(anëtare)</b>         |

*Shënim:* Nuk mori pjesë në mbledhje zonja *Naureda Llagami*, Kryetare e Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe zoti *Dritan Hallunaj*, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë institucionit.*
4. *Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë institucionit.*
5. *Elis Kuçi, Specialist pranë institucionit.*
6. *Valbona Bako, Specialiste pranë institucionit.*
7. *Edlira Bako, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
8. *Migena Kondo, Komiteti Shqiptar i Helsinkit.*
9. *Klara Kodra, Qendra Evropiane.*
10. *Gregor Borgowski, EURALIUS.*
11. *Klodian Rado, EURALIUS.*
12. *Erion Fejzulla, USAID.*
13. *Marjana Papa, OSCE.*

#### **RENDI I DITËS:**

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi fillimin e procedurës së transferimit të përkohshëm dhe shpalljen e një pozicioni të lirë për transferim të përkohshëm në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

*Maksim Qoku:* Çështja e radhës, çështja nr. 5.

Relatore, zonja Shehu! Fjala për ju!

*Marçela Shehu:* Po! Faleminderit!

Propozimi i dytë ka lidhje me një propozim që Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i paraqet Këshillit të Lartë Gjyqësor po për Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, tashmë duke parashikuar edhe ndryshimet të cilat u parashikuan në Rregulloren e transferimit. Komisioni vendosë të propozojë, çmon se duhet t'i paraqesë Këshillit për propozim shpalljen e një pozicioni të lirë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, sipas procedurës që është parashikuar në këtë relacion.

Komisioni ka vlerësuar se sërish kjo gjykatë është një “gjykatë në nevojë”, ka një pozicion të lirë të përkohshëm, ka një situatë të tillë që cenon funksionin normal të kësaj gjykate. Pra plotësohen të gjitha kushtet që parashikon Rregullorja e transferimit për të konsideruar gjykatë në nevojë dhe për të kërkuar plotësimin e saj me një transferim të përkohshëm, pasi sërish Komisioni vlerëson se këto nevoja nuk mund të plotësohen as nëpërmjet skemës së delegimit dhe as nëpërmjet Rregullores së miratuar nga Këshilli për delegimin e gjyqtarëve për çështje të veçanta.

Lidhur me propozimin konkret, pas ndryshimeve të parashikuara në Rregulloren e transferimit, Komisioni vlerëson si më të përshtatshëm në rastin konkret, që pëlqimi t'i kërkohej fillimisht gjyqtarit që është i transferuar në këtë gjykatë, zotit {...}, për të kërkuar pëlqimin për zgjatjen e periudhës së transferimit të tij. Si në rastin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, ky pëlqim i kërkohej për një periudhë të caktuar, deri më 15.09.2019, pasi Komisioni ka vlerësuar që kjo është një kohë e mjaftueshme edhe për Këshillin që të vendosë lidhur me masat e nevojshme për caktimin dhe emërimin e magistratëve kandidatë për gjyqtarë.

Lidhur me funksionin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, nga ky vjen zoti {...}, Komisioni ka vlerësuar edhe funksionalitetin e kësaj gjykate. Kjo gjykatë ka në detyrë dy gjyqtarë dhe njëri prej tyre është i transferuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, por kthimi i gjyqtarit {...} në Gjykatën Pukë, sipas vlerësimit të Komisionit gjithmonë, në situatën aktuale, do të rrezikonte funksionimin normal të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, pasi tashmë është fakt i njohur që kryetarja e kësaj gjykate, prej më shumë se 1 viti është në proces rivlerësimi nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe pritet që në ditët në vijim të ketë një seancë dëgjimore për rivlerësimin e saj. Ndaj për të shmangur çdo problem që mund të shkaktonte një vendimmarrje e



caktuar e këtij komisioni, në çdo rast hipotetik, Komisioni vlerëson që transferimi i përkohshëm i gjyqtarit {...} është opsioni më i përshtatshëm, në kushtet kur hapja e procedurës së transferimit për të gjithë gjyqtarët, do të kërkonte një kohë të caktuar dhe mund të vinte në rrezik funksionimin e kësaj gjykate.

Vlen të theksohet se gjyqtari {...} ka aktualisht në gjykim 523 çështje, ndaj përveç situatës së parashtruar më sipër, edhe ndërprerja e gjyqimit të këtyre çështjeve nga ana e gjyqtarit, jo vetëm do të cenonte funksionin normal të gjykatës, por do të cenonte rëndë dhe interesat e ligjshme të shtetasve.

Bazuar sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor: Të shpallë një pozicion të lirë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër për transferim të përkohshëm deri me date 15.09.2019; Thirrja t'i drejtohet gjyqtarit të transferuar aktualisht në këtë gjykatë, zotit {...}, i cili të ftohet për të dhënë pëlqimin për përsëritjen e transferimit të përkohshëm; Afati për dhënien e pëlqimit për transferim të jetë 3 ditë, duke filluar nga dita e publikimit të thirrjes në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor; Ngarkohet Komisioni i Zhvillimit të Karrierës për ndjekjen e hapave të mëtejshëm të procedurës së transferimit të përkohshëm. Faleminderit!

**Maksim Qoku:** Faleminderit, zonja Shehu!

Fjala për anëtarët, nëse kanë opsionin e tyre!

Atëherë, duke qenë gjithçka në logjikën ... dhe dakord, unë do të jem vetëm për opsionin e afatit 1-vjeçar, kështu që do të desha ta hidhnim në votim propozimin tim për një afat 1-vjeçar, pastaj kalojmë në atë të...

Okej! Fjala për ju zoti Toska!

**Ilir Toska:** Të bëj një sqarim, se si duket nuk u theksua nga zonja Shehu.

Gjyqtari {...} është i transferuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë për në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër. Nga ana tjetër, për shkak të nevojës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, kemi transferuar 1 gjyqtar të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor dhe e kemi dërguar në Pukë. Praktikisht, gjyqtari i Shkodrës ka tashmë më shumë se 6 muaj që është i transferuar. Kemi pas në konsideratë edhe këtë moment, ku do duhet të ribëjmë edhe një herë transferimet në shtator, duke konsideruar edhe transferimet

e mëparshme të gjyqtarit të rrethit gjyqësor Shkodër për në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë. Faleminderit!

**Maksim Qoku:** Faleminderit, zoti Toska!

I mbetem atij propozimi, kështu që e kalojmë në votim.

**Brikena Ukperaj:** Të shtoj diçka?

**Maksim Qoku:** Po!

**Brikena Ukperaj:** Lidhur me situatën e krijuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë dhe Gjykatën e Shkallës së Parë Administrative Shkodër, në logjikën time, mbështes propozimin e Komisionit të Karrierës për arsye sepse nuk mundet që të shpallim një vend për transferim të përkohshëm dhe të transferojmë një gjyqtar nga një gjykatë dhe në vendin e tij vakant pastaj, të transferojmë një gjykatë tjetër. Ideja është që transferimi i përkohshëm duhet të funksionojë në mënyrë të tillë që të mos dëmtohet funksionaliteti i gjykatës nga e cila gjyqtari transferohet. Aktualisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë organika është 4 gjyqtarë. Ka 1 gjyqtar të caktuar në mënyrë të përhershëm dhe lidhur me tre vendet vakante pastaj që janë, duhet të jetë 1 gjyqtar i transferuar dhe është transferuar, ndërkohë që ka gjyqtarë të caktuar në mënyrë të përhershme, pra ka qenë gjyqtari që është transferuar në Shkodër, ka edhe 1 vend tjetër të caktuar në mënyrë të përkohshme që është ish-kryetari i gjykatës që është aktualisht i pezulluar. Pra edhe vështirësia për të caktuar një magjistrat tjetër, ndoshta do të jetë më e madhe sepse mbetet ndoshta një vend i caktuar në mënyrë të përhershme, në qoftë se do të llogarisim edhe magjistratët. Prandaj, për të rregulluar gjithë këtë situatë, unë e mendoj të nevojshme që transferimi i zotit {...} në Gjykatën e Shkallës së Parë Administrative Shkodër, të vazhdojë për një periudhë 3-mujore (deri në shtator), në mënyrë që të mos mbetet Gjykata e Shkallës së Parë Administrative Shkodër me 1 gjyqtar. Pastaj, ecuria e mëtejshme si do të vazhdojë, nëse do të jetë kryetarja apo jo, do të mbetet përsëri në vlerësimin tonë. Prandaj, mbështes propozimin për afatin 3-mujor të transferimit.

**Maksim Qoku:** Faleminderit, zonja Ukperaj!

Në fakt, logjika jonë është e njëjtë. Thjesht kemi këndvështrime të ndryshme. Domethënë, ju jeni për një afat të kufizuar 3-mujor, ndërkohë unë them që një afat 1-vjeçar, por e kufizojmë kur ne e shikojmë të arsyeshme. Domethënë, kjo është ideja e një

risku. Nëse mundet që brenda tremuajshit ne të bëjmë një emërim, nëse mundet brenda këtij tremuajshi del në veting kryetarja e... Pra kjo është logjika. Dhe unë them që vejmë një afat 1-vjeçar, në aspektin që ne e kemi në dorë, aq më tepër dhe një precedent që e ndërpresim kur duam. Kjo është. Për të tjerat jam shumë dakord me logjikën. Faleminderit!

**Ilir Toska:** Emërimin e magjistratëve do duhet ta bëjmë shumë shpejt se 3 muaj. Kjo është edhe arsyeja e parë. Arsyeja e dytë është që nëse do duhet të transferojmë në mënyrë të përkohshme për një periudhë të kufizuar gjyqtarin që është aktualisht i transferuar do duhet të konsiderojmë, në momentin nëse jep ai pëlqimin, që të mos marri më çështje në short sepse do vazhdojë të ngarkohet dhe do të jemi në po të njëjtën situatë se si do zhblllokojmë çështjen që vazhdon të marri në short. Pra nëse na jep pëlqimin, në momentin që do duhet të marrim vendim për transferim, do të duhet të konsiderojmë edhe fatin e shortit për këtë gjyqtar që transferohet për një periudhë shumë të kufizuar kohe. Kjo është arsyeja që kemi bërë propozimin. Faleminderit!

**Maksim Qoku:** Faleminderit, zoti Toska!

Normalisht, po ju jap të drejtë në aspektin logjik sepse thashë këndvështrimi na ndryshon dhe tërhiqem nga propozimi im. Kalojmë në votim projekt-aktin.

**Brunilda Kadi:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Pro.

*(Vota e zonjës Shehu nuk dëgjohet.)*

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Kundër.

**Maksim Qoku:** Dakord.

\* \* \*

(Pika 5 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2019

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 17.06.2019)*

**Pika 6 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi shfuqizimin e vendimit nr. 61, datë 24.04.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për fillimin e procedurës së transferimit të përkohshëm dhe shpalljen e një pozicioni të lirë të përkohshëm për transferim në Gjykatën Rrethit Gjyqësor Kurbin”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

*Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Maksim Qoku.*

*Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 14:13 dhe mbaroi në orën 15:55.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. **Maksim Qoku** (zëvendëskryetar)
2. **Medi Bici** (anëtar)
3. **Fatmira Luli** (anëtare)
4. **Brunilda Kadi** (anëtare)
5. **Ilir Toska** (anëtar)
6. **Alban Toro** (anëtar)
7. **Brikena Ukperaj** (anëtar)
8. **Erjon Muharremaj** (anëtar)
9. **Marçela Shehu** (anëtare)

*Shënim:* Nuk mori pjesë në mbledhje zonja *Naureda Llagami*, Kryetare e Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe zoti *Dritan Hallunaj*, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë institucionit.*
- 4. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë institucionit.*
- 5. Elis Kuçi, Specialist pranë institucionit.*
- 6. Valbona Bako, Specialiste pranë institucionit.*
- 7. Edlira Bako, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 8. Migena Kondo, Komiteti Shqiptar i Helsinkit.*
- 9. Klara Kodra, Qendra Evropiane.*
- 10. Gregor Borgowski, EURALIUS.*
- 11. Klodian Rado, EURALIUS.*
- 12. Erion Fejzulla, USAID.*
- 13. Marjana Papa, OSCE.*

#### **RENDI I DITËS:**

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi shfuqizimin e vendimit nr. 61, datë 24.04.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për fillimin e procedurës së transferimit të përkohshëm dhe shpalljen e një pozicioni të lirë të përkohshëm për transferim në Gjykatën Rrethit Gjyqësor Kurbin”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

*Maksim Qoku:* Atëherë, kalojmë në çështjen e radhës. Pika nr. 6. Shqyrtimi i projektvendimit mbi shfuqizimin e vendimit nr. 61 për sa i përket Gjykatës Kurbin.

Fjala për ju zonja Shehu!

*Marçela Shehu:* Po! Faleminderit!

Edhe për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin, ashtu si edhe për Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, Këshilli ka disponuar në mbledhjen e datës 24.04.2019 dhe me vendimin nr. 61 të këtij Këshilli është vendosur shpallja e një pozicioni të lirë të përkohshëm pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin. Është autorizuar Komisioni për vijimin e procedurave të mëtejshme dhe janë përcaktuar Gjykatat e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Durrës si gjykata nga të cilat do të kryhet transferimi i përkohshëm i një gjyqtari pranë kësaj gjykate.

Pas ndryshimeve që pësoi Rregullorja për transferimin, të cilat ne i cituam edhe në relacionin për Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, Komisioni vlerëson se ky vendim tashmë duhet rivlerësuar, pasi një nga ndryshimet kryesore që sollën ndryshimet e Rregullores së transferimit ishte pikërisht përfshirja e të gjithë gjyqtarëve që plotësonin kriteret për pozicionin e lirë të shpallur në dhënien e pëlqimit. Në këto kushte, duke qenë se fillimisht ne i përcaktuam gjykatat nga të cilat do të kërkohej pëlqimi, tashmë jemi në një situatë që nuk mund të kemi më këtë kufizim bazuar në rregullimet e reja të Rregullores për transferimin.

Në këto kushte, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor: Të shfuqizojë vendimin nr. 61, datë 24.04.2019 “Mbi fillimin e procedurës së transferimit të përkohshëm dhe shpalljen e një pozicioni të lirë të përkohshëm për transferim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin”, si dhe të procedurave të ndjekura nga ky Komision në zbatim të këtij vendimi. Faleminderit!

***Maksim Qoku:*** Faleminderit, zonja Shehu!

Nëse nuk ka diskutime, e kalojmë në votim?

***Brunilda Kadi:*** Pro.

***Ilir Toska:*** Dakord.

***Alban Toro:*** Dakord.

***Fatmira Luli:*** Pro.

***Marçela Shehu:*** Dakord.

***Erjon Muharremaj:*** Pro.

***Brikena Ukperaj:*** Pro.

***Medi Bici:*** Pro.

*Maksim Qoku*: Dakord.

\* \* \*

(Pika 6 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2019

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 17.06.2019)*

**Pika 7 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi fillimin e procedurës së transferimit të përkohshëm dhe shpalljen e një pozicioni të lirë për transferim të përkohshëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

***Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Maksim Qoku.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 14:13 dhe mbaroi në orën 15:55.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
2. ***Medi Bici*** (anëtar)
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
5. ***Illir Toska*** (anëtar)
6. ***Alban Toro*** (anëtar)
7. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
8. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)
9. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

*Shënim:* Nuk mori pjesë në mbledhje zonja *Naureda Llagami*, Kryetare e Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe zoti *Dritan Hallunaj*, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë institucionit.*
- 4. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë institucionit.*
- 5. Elis Kuçi, Specialist pranë institucionit.*
- 6. Valbona Bako, Specialiste pranë institucionit.*
- 7. Edlira Bako, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 8. Migena Kondo, Komiteti Shqiptar i Helsinkit.*
- 9. Klara Kodra, Qendra Evropiane.*
- 10. Gregor Borgowski, EURALIUS.*
- 11. Klodian Rado, EURALIUS.*
- 12. Erion Fejzulla, USAID.*
- 13. Marjana Papa, OSCE.*

#### **RENDI I DITËS:**

7. Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi fillimin e procedurës së transferimit të përkohshëm dhe shpalljen e një pozicioni të lirë për transferim të përkohshëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

*Maksim Qoku:* Atëherë, kalojmë në çështjen e radhës. Çështja nr. 7.

Fjala është po për ju zonja Shehu!

*Marçela Shehu:* Po! Faleminderit!

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës çmon të propozojë Këshillit fillimin e procedurës së transferimit të përkohshëm dhe shpalljen e pozicionit të lirë për transferim

të përkohshëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin. Ashtu sikurse edhe në mbledhjen e datës 24.04.2019 ky Komision ka rivlerësuar sërish situatën në këtë gjykatë duke konsideruar se kjo gjykatë vijon të jetë një “gjykatë në nevojë”, në kuptim të Rregullores për transferimin.

Organika e kësaj gjykate është e përbërë nga 4 gjyqtarë. Aktualisht ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme 2 gjyqtarë. Ndërkohë që janë 2 pozicione të lira të përkohshme. Kjo situatë ka sjellë një ngarkesë të lartë të punës së këtyre 2 gjyqtarëve që ushtrojnë funksionin aktualisht, si dhe ka sjellë vështirësi edhe në gjykimin e çështjeve penale, ashtu si e kemi cituar në relacionin e datës 24.04.2019. Tashmë me ndryshimet e Kodit të Procedurës Penale për gjykimin e një çështjeje penale kërkohet implikimi i të paktën tre gjyqtarëve, çka ka sjellë vështirësi në këtë gjykatë, ndoshta edhe në disa gjykata të tjera për gjykimin e këtyre lloj çështjesh.

Në këto kushte, Komisioni i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor: Të shpallë një pozicion të lirë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin për transferim të përkohshëm deri në 1 vit; Thirrja t’i drejtohet të gjithë gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm që plotësojnë kriteret për transferim të përkohshëm, të cilët të ftohen për të dhënë pëlqimin për këtë transferim; Afati për dhënien e pëlqimit për transferim të përkohshëm të jetë 2 (javë), duke filluar nga dita e publikimit të thirrjes në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor; Ngarkohet Komisioni i Zhvillimit të Karrierës për ndjekjen e hapave të mëtejshëm të procedurës së transferimit të përkohshëm. Faleminderit!

**Maksim Qoku:** Faleminderit, zonja Shehu!

Nëse e do fjalën dikush nga anëtarët, apo nëse s’keni gjë, mund ta kalojmë në votim.

**Brunilda Kadi:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

*(Vota e zonjës Luli nuk dëgjohet.)*

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

*Brikena Ukperaj*: Pro.

*Medi Bici*: Pro.

*Maksim Qoku*: Pro.

\* \* \*

(Pika 7 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2019

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 17.06.2019)*

**Pika 8 e rendit të ditës me objekt:** Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme” i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

***Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Maksim Qoku.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 14:13 dhe mbaroi në orën 15:55.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                            |                          |
|----------------------------|--------------------------|
| <b>1. Maksim Qoku</b>      | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>2. Medi Bici</b>        | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>3. Fatmira Luli</b>     | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>4. Brunilda Kadi</b>    | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Ilir Toska</b>       | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>6. Alban Toro</b>       | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Brikena Ukperaj</b>  | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>8. Erjon Muharremaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>9. Marçela Shehu</b>    | <b>(anëtare)</b>         |

*Shënim:* Nuk mori pjesë në mbledhje *zonja Naureda Llagami*, Kryetare e Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe *zoti Dritan Hallunaj*, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë institucionit.*
- 4. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë institucionit.*
- 5. Elis Kuçi, Specialist pranë institucionit.*
- 6. Valbona Bako, Specialiste pranë institucionit.*
- 7. Migena Kondo, Komiteti Shqiptar i Helsinkit.*
- 8. Klara Kodra, Qendra Evropiane.*
- 9. Marjana Papa, OSCE.*

#### **RENDI I DITËS:**

8. Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme” i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

*Maksim Qoku:* Kaluam në çështjen e fundit të rendit të ditës, ajo e caktimit të gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme, i përgatitur nga...

Zoti Toska, fjala për ju!

*Ilir Toska:* Atëherë, nën vazhden e mbledhjeve periodike gati njëmuajore që Këshilli i Lartë Gjyqësor trajton kërkesat e gjykatave në nevojë për çështjet gjyqësore të veçanta, edhe në mbledhjen e sotme kemi sërish rreth 70 kërkesa nga gjykatat në nevojë, një numër konstant ky, por që ka tendencë të rritet.

Fillimisht kemi bërë një relacion për radhën e procedurave të shortit sipas gjykatave. Kemi propozuar që të fillojë shorti me gjykatat e apeleve sipas kësaj radhe: Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda.

Më pas gjykatat e apelit me juridiksion të përgjithshëm: Fillimisht Gjykata e Apelit Korçë, më pas Gjykata e Apelit Vlorë, më pas Gjykata e Apelit Durrës, më pas Gjykata e Apelit Shkodër, më pas Gjykata e Apelit Tiranë dhe në fund Gjykata e Apelit Gjirokastër.

Më tej procedurat e shortit vazhdojnë me gjykatat e shkallës së parë, sipas kësaj radhe: Fillimisht gjykatat e shkallës së parë sipas juridiksionit të gjykatës së apelit me juridiksion të përgjithshëm, fillimisht ato të juridiksionit të Gjykatës së Apelit Tiranë, konkretisht: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin, më pas Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë dhe në fund Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër. Më pas procedurat e shortit vazhdojnë për gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Shkodër, fillimisht Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë, më pas Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe në fund Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë.

Më tej shorti të vazhdojë për gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Gjirokastër, që është vetëm Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet.

Më tej shorti të vazhdojë për gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Korçë, që është vetëm Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec.

Dhe së fundi, shorti të vazhdojë me gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit administrativ, fillimisht për Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, dhe më pas Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Korçë.

Jeni të lutur të votoni këtë propozim.

**Maksim Qoku:** Faleminderit, zoti Toska!

Ka diskutime?

Kalojmë në votim për radhën?

**Brunilda Kadi:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

*Marçela Shehu:* Dakord.

*Erjon Muharremaj:* Pro.

*Brikena Ukperaj:* Pro.

*Medi Bici:* Pro.

*Maksim Qoku:* Dakord.

Fillojmë procedurat e shortit.

Administrata!

*Ilir Toska:* Mirë! Vazhdojmë me procedurat e shortit për caktimin e gjyqtarit në **Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda**. Deri më datë 14 qershor është paraqitur vetëm 1 kërkesë për 1 çështje penale nga Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda, përmes së cilës kërkohet caktimi i 1 gjyqtari.

Ndërsa janë të pazbatueshme mekanizmi i skemës së delegimit dhe mekanizmi i transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, kemi propozuar që të zbatohet vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”. Lidhur me këtë kemi propozuar që gjykata nga duhet të përzgjidhet me short gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Apelit Tiranë. Ndërsa numri i gjyqtarëve që duhet të caktohet për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë të jetë 1. Jeni dakord me këtë propozim të Komisionit?

*Maksim Qoku:* Okej! Bëjmë votim me dorë.

Konstatohet që janë të gjithë dakord.

Procedojmë!

*Ilir Toska:* Mirë! Atëherë, vazhdojmë!

Meqenëse Këshilli u shpreh dakord me propozimin, për hapat e shortit që duhet të ndiqen, Komisioni propozon që gjyqtari që duhet të përzgjidhet për çështjen gjyqësore të veçantë në Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda, të përzgjidhet me short nga gjyqtarët e seksionit penal të Gjykatës së Apelit Tiranë, por duke përjashtuar në këtë rast gjyqtarin {...}, që është anëtar i Kolegjit Zgjedhor, po kështu të përjashtohet nga shorti edhe gjyqtari i seksionit penal të Gjykatës së Apelit Tiranë që është në prag të mbushjes së



moshës së pensionit të pleqërisë në shtator të vitit 2019, zoti {...}. Po kështu, kemi propozuar të përjashtohen nga shorti edhe gjyqtarët e seksionit penal të Gjykatës së Apelit Tiranë, të cilët janë caktuar më herët në më tepër se 2 çështje gjyqësore të veçanta, në fakt janë ngarkuar në më tepër se 8 çështje gjyqësore të veçanta, në gjykata të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin, që janë zonja {...} dhe zoti {...}. Jeni dakord me këtë propozim?

**Maksim Qoku:** Votim me dorë.

Të gjithë dakord.

**Ilir Toska:** Mirë! Atëherë, meqenëse Këshilli është dakord me propozimin, vazhdojmë me procedurat e shortit për përzgjedhjen e 1 gjyqtari nga gjyqtarët e seksionit penal të Gjykatës së Apelit Tiranë, duke përjashtuar gjyqtarët {...}, {...}, {...} dhe {...}. Të tjerët duhet t'i fusim në një enë.

Emri i parë është {...}. I kemi hedhur në një enë dhe tani do të përzgjedhim emrin e një prej gjyqtarëve – {...}.

Atëherë, për 1 çështje gjyqësore që paraqet nevojë Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda, është përzgjedhur nga shorti gjyqtari {...}. Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda.

Vazhdojmë me procedurat e shortit për caktimin e gjyqtarit në **Gjykatën e Apelit Korçë**. Gjykata e Apelit Korçë deri më datë 14.06.2019 ka paraqitur kërkesa dhe është në nevojë për 16 çështje gjyqësore, nga të cilat 9 çështje penale dhe 8 çështje civile. Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizmi i skemës së delegimit dhe i transferimit të përkohshëm dhe është propozuar që të zbatohet vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”. Lidhur me këtë, Komisioni ka propozuar që gjykata nga duhet të përzgjidhen me short gjyqtarët që do caktohen për gjykimin e 16 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Apelit Tiranë, Gjykata e Apelit Gjirokastrë dhe Gjykata e Apelit Shkodër. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohet për gjykimin e 16 çështjeve gjyqësore të veçanta të jetë 7 gjyqtarë (3 gjyqtarë nga Gjykata e Apelit Tiranë, 3 gjyqtarë

nga Gjykata e Apelit Gjirokastrë dhe 1 gjyqtar nga Gjykata e Apelit Shkodër). Jeni dakord me këtë propozim të Komisionit?

**Maksim Qoku:** Dakord, me ngritje dore.

**Ilir Toska:** Mirë! Meqenëse Këshilli është dakord me këtë propozim, vijojmë me propozimin e radhës. Lidhur me hapat e shortit që do të ndiqen, Komisioni ka në konsideratë gjyqtarët që do caktohen nga 3 gjykatat e apelit duke patur në konsideratë edhe lëndën e çështjeve, penale dhe civile, numrin e gjyqtarëve që kërkohen të caktohen për secilën çështje, konkretisht nga 1 gjyqtar për 3 çështje, nga 2 gjyqtarë për 9 çështje dhe 3 gjyqtarë për 4 çështje, sikundër edhe formimin e trupave gjykues për çështjet që paraqet nevojë Gjykata e Apelit Korçë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon që për 9 çështjet penale të caktohen 4 gjyqtarë (1 gjyqtar i Gjykatës së Apelit Shkodër dhe 3 gjyqtarë të seksionit penal të Gjykatës së Apelit Tiranë) si më poshtë:

Për çështjen penale nr.1, për të cilën kërkohet caktimi i 1 (një) gjyqtari, ndërsa trupi gjykues i caktuar për gjykimin e saj ka në përbërje 2 (dy) gjyqtarë të Gjykatës së Apelit Shkodër, konkretisht gjyqtarët {...} dhe {...}, si i përzgjedhur ngas shorti për këtë çështje të konsiderohet gjyqtari i tretë që është në përbërje të trupit gjykues me dy gjyqtarët si më lart në gjykatën nga e cila ata vijnë, konkretisht gjyqtarja {...}. Ky propozim është bërë referuar Rregullores, ku kemi konsideruar që në çdo rast, në përzgjedhjen e një gjyqtari, automatikisht përcakton edhe përzgjedhjen e të gjithë trupit gjykues. Në këtë rast jemi në situatën kur janë dy gjyqtarët e apelit Shkodër dhe do duhet të përzgjedhim të tretin. I treti kemi propozuar që të jetë gjyqtari që është në përbërje të trupit gjykues me dy gjyqtarët e tjerë. Jeni dakord?

**Maksim Qoku:** Dakord anëtarët?

Me ngritje dore.

Të gjithë anëtarët dakord.

**Ilir Toska:** Mirë! Atëherë, për çështjen penale nr. 1 caktohet në përbërje të trupit gjykues gjyqtarja {...}.

Për çështjen penale nr.7, për të cilën kërkohet caktimi i 3 gjyqtarëve, ata të përzgjidhen, me short, nga gjyqtarët e seksionit penal të Gjykatës së Apelit Tiranë. Në këtë rast, gjyqtari i përzgjedhur i pari është automatikisht dhe relator i çështjes. Kemi

propozuar si edhe në rastin e më hershëm që të përjashtohen nga shorti gjyqtari i seksionit penal i Gjykatës së Apelit Tiranë që është anëtar i Kolegjit Zgjedhor, zoti {...}. Të përjashtohet nga shorti edhe gjyqtari që është në prag të mbushjes së moshës së pensionit të pleqërisë, zoti {...}, si dhe 2 gjyqtarët që janë ngarkuar më herët në më shumë çështje gjyqësore të veçanta të seksionit penal të Gjykatës së Apelit Tiranë, zonja {...} dhe zoti {...}.

Jeni dakord me këtë propozim?

*(Anëtarët e Këshillit janë të gjithë dakord.)*

Mirë! Atëherë, vazhdojmë procedurat e shortit për çështjen penale nr. 7. Do të përzgjedhim 3 gjyqtarë nga seksioni penal i Gjykatës së Apelit Tiranë. Futim në një enë emrat e gjyqtarëve. Janë {...}, {...}, {...}, {...} dhe {...}.

Do përzgjedhim emrat e 3 prej tyre. I pari do të jetë edhe relator për çështjen nr. 7.

{...} është gjyqtari i parë që është edhe relator për çështjen nr. 7.

Emri i dytë është {...} dhe emri i tretë është {...}.

Me kaq mbyllen procedurat për çështjen penale nr. 7.

Vazhdojmë për 6 çështjet penale, ato nr. 2, nr. 4, nr. 5, nr. 6, nr. 8 dhe nr. 9, për të cilat kërkohet caktimi i 2 gjyqtarëve. Për secilën nga ato, gjyqtarët të përzgjidhen me short ndërmjet atyre të caktuar për çështjen nr.7. Në këtë rast, gjyqtari i caktuar si relator për çështjen nr.7, nuk mund të ngarkohet në më tepër se 3 nga këto çështje. Jeni dakord.

*(Anëtarët e Këshillit janë të gjithë dakord.)*

Atëherë, fusim në një enë çështjet nr. 2, nr. 4, nr. 5, nr. 6, nr. 8 dhe nr. 9. Fusim në një enë emrat e tre gjyqtarëve që u përzgjedhën për çështjen nr. 7. Do t'i marrim me radhë për secilën nga çështjet. {...}, {...} dhe {...}. Zhvillojmë procedurat e shortit për çështjen nr. 2. Do të përzgjedhim emrat e 2 gjyqtarëve.

Emri i parë është {...}. Emri i dytë është {...}.

Pra për çështjen nr. 2 janë gjyqtarët {...} dhe {...}.

Vazhdojmë procedurat e shortit për çështjen nr. 4. Fusim në enë emrat e tre gjyqtarëve përsëri, për të përzgjedhur 2 prej tyre.

Emri i parë është {...}. Emri i dytë është {...}.

Këto janë përsëri për çështjen nr. 4.

Vazhdojmë për çështjen nr. 5. Fusim emrat e 3 gjyqtarëve në një enë dhe përzgjedhim dy prej tyre.

Emri i parë është {...}. Emri i dytë është {...}.

Pra për çështjen nr. 5 janë gjyqtarët {...} dhe {...}.

Vazhdojmë për çështjen nr. 6. Fusim në enë përsëri emrat e 3 gjyqtarëve. Do të përzgjedhim 2 prej tyre.

Emri i parë është {...}. Emri i dytë është {...}.

Vazhdojmë procedurat e shortit për çështjen nr. 8. Do përzgjedhim emrat e dy gjyqtarëve.

{...} dhe {...}.

Për çështjen nr. 9, ndërsa gjyqtari {...} u ngarkua si relator tek çështja nr. 7 dhe në tre çështje të tjera ku kërkohen dy gjyqtarë, automatikisht mbesin për çështjen nr. 9 gjyqtarët {...} dhe {...}.

Vazhdojmë për çështjen nr. 3 për të cilën kërkohet caktimi i një gjyqtari, ai të përzgjidhet me short ndërmjet gjyqtarëve të caktuar për çështjen nr. 7, pra mes tre gjyqtarëve {...}, {...} dhe {...}. Duhet të përzgjedhim njërin prej tyre për ta caktuar për çështjen nr. 3.

Atëherë, përzgjidhet gjyqtari {...}.

Me kaq mbyllen procedurat e shortit për çështjet penale.

Vazhdojmë me procedurat e shortit për 7 çështjet civile, për të cilat kemi propozuar që të caktohen 3 gjyqtarë të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë. Në këtë rast, sa i përket gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, kemi propozuar që të përjashtohet nga shorti vetëm kryetari i gjykatës së apelit, zoti {...}. Jeni dakord me këtë propozim?

*(Anëtarët e Këshillit janë të gjithë dakord.)*

Dakord. Vazhdojmë atëherë me procedurat e shortit.

Për çështjen civile nr.13, për të cilën kërkohet caktimi i 3 gjyqtarëve, ata të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë. Në këtë rast, gjyqtari i përzgjedhur i pari është automatikisht dhe relator i çështjes. Po kështu, përveç kryetarit të gjykatës duhet të përjashtohet edhe anëtari i Kolegjit Zgjedhor, zoti {...}.

*(Anëtarët e Këshillit janë të gjithë dakord.)*

Atëherë, fusim në një enë emrat e gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Gjirokastër: {...}, {...}, {...} dhe {...}. Do përzgjedhim tre prej tyre dhe gjyqtari i përzgjedhur i pari është edhe relatori i çështjes nr. 13.

Atëherë, emri i përzgjedhur i pari është gjyqtarja {...}. Do të përzgjedhim edhe dy të tjerë. {...} është edhe relatores e çështjes.

Emri i dytë është {...} dhe emri i tretë është {...}.

Mbyllen procedurat e shortit edhe për çështjen 13.

Vazhdojmë procedurat e shortit për çështjet civile 11 dhe 12 për të cilat kërkohet caktimi i dy gjyqtarëve. Për secilën nga ato gjyqtarët të përzgjidhen me short ndërmjet atyre të caktuar për çështjen nr.13. Në këtë rast, gjyqtari i caktuar si relator për çështjen nr.13, nuk mund të ngarkohet në më tepër se 1 nga këto çështje.

Pra bëjmë procedurat e shortit për çështjen nr. 11. Fusim emrat e tre gjyqtarëve të përzgjedhur për çështjen nr. 13: Janë {...}, {...}, {...}. Do përzgjedhim 2 prej tyre që të caktohen për çështjen 11.

Emri i parë është {...}. Emri i dytë është {...}.

Meqenëse propozimi është që gjyqtari që caktohet relator për çështjen nr. 13 nuk mund të ngarkohet në më shumë se 1 çështje në ato që kërkohet caktimi i 2 gjyqtarëve, automatikisht për çështjen 12, mbesin të caktohen gjyqtarët {...} dhe {...}.

Për çështjet civile 15 dhe 16 për të cilat kërkohet caktimi i 3 gjyqtarëve, si të përzgjedhur nga shorti të konsiderohen gjyqtarët e caktuar për çështjen nr. 13 dhe këto janë çështje që kanë të bëjnë me përjashtim gjyqtarësh. Në këto raste shorti zhvillohet vetëm për caktimin e gjyqtarit relator për secilën nga këto çështje, ku gjyqtari i përzgjedhur i pari caktohet relator për çështjen e renditur e para në listë, duke përjashtuar nga shorti çështjen e renditur më pas në listë. Pra kemi në një enë numrat 15 dhe 16 të çështjeve dhe në enën tjetër emrat e tre gjyqtarëve {...}, {...} dhe {...}.

Atëherë vazhdojmë, zgjedhim një nga numrat e çështjeve. Numri i parë është 15 dhe përzgjedhim emrin e një gjyqtari që është edhe relator për çështjen - Është {...}.

Për çështjen nr. 16 përzgjedhim emrin e gjyqtarit që është relator – Është {...}. Pra për çështjen nr. 15 është relator {...}, ndërsa për çështjen nr. 16 relator është {...}. Treshja është {...}, {...} dhe {...}.

Vazhdojmë për çështjen civile nr. 10 për të cilën kërkohet caktimi i 2 gjyqtarëve, ata të përzgjidhen me short ndërmjet gjyqtarëve të caktuar për çështjen 13. Do të fusim në një enë emrat e 3 gjyqtarëve si më lart, për të përzgjedhur 2 prej tyre të cilët do caktohen për çështjen nr. 10.

Emri i parë është {...}. Emri i dytë është {...}. Caktohen për çështjen civile nr. 10.

Ndërkohë, për çështjen civile nr. 14, për të cilën kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, si i përzgjedhur nga shorti të konsiderohet gjyqtari tjetër që nuk është caktuar për çështjen nr. 10, që i bie të ngelet gjyqtarja {...}. Pra për çështjen civile nr. 14 për të cilën kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, gjyqtari që caktohet është {...}.

Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Apelit Korçë.

Vazhdojmë me procedurat e shortit për **Gjykatën e Apelit Vlorë**. Gjykata e Apelit Vlorë ka paraqitur nevojë për 4 çështje, 1 çështje civile dhe 3 çështje penale. Në këtë gjykatë, për dy nga këto çështje, trupat gjykues janë të formuar. Çështja nr. 2 përbëhet nga dy gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Korçë, ndërsa në rastin e tretë përbëhet nga 1 gjyqtar i Gjykatës së Apelit Vlorë. Në këtë rast, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, duke konsideruar se zbatimi i skemës së delegimit dhe i transferimit të përkohshëm është i pamundur, kemi propozuar të zbatohet vendimi “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, konkretisht kemi propozuar që gjykata nga duhet të përzgjidhen me short gjyqtarët që duhet të caktohen për gjykimin e 4 çështjeve gjyqësore të veçanta të jetë Gjykata e Apelit Korçë dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e këtyre 4 çështjeve gjyqësore, të jetë 2. Në këtë rast kemi propozuar që të përjashtohen nga shorti për çështjen nr. 2 gjyqtarët {...} dhe {...}, të cilat janë aktualisht në përbërje të trupit gjykues për këtë çështje. Po kështu, për çështjen nr. 1, 3 dhe 4, kemi propozuar të përjashtohet nga shorti gjyqtari i Gjykatës së Apelit Korçë që është ngarkuar më herët me një numër shumë të lartë çështjesh gjyqësore, që është gjyqtare {...}. Ndërkohë kemi propozuar të mos përjashtohet nga shorti kryetarja në detyrë e Gjykatës së Apelit Korçë, zonja {...}. Jeni dakord me këtë propozim?

*(Anëtarët e Këshillit janë të gjithë dakord.)*

Mirë atëherë, vazhdojmë procedurat e shortit. Për çështjen nr. 2 për të cilën kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, të përzgjidhet me short ndërmjet gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Korçë, të cilët nuk janë caktuar më herët për gjykimin e kësaj çështjeje, konkretisht ndërmjet gjyqtarëve {...} dhe {...}. Duhet të përzgjedhim njërin prej këtyre gjyqtarëve që të formojë treshen për çështjen në nevojë në Gjykatën e Apelit Vlorë.

Atëherë është gjyqtari {...} që caktohet për çështjen nr. 2.

Për çështjen nr. 1 dhe nr. 4 për të cilat kërkohet caktimi i 2 gjyqtarëve, ata të përzgjidhen me short ndërmjet gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Korçë, duke përjashtuar gjyqtaren {...}.

Emrat e tre gjyqtarëve janë {...}, {...} dhe {...}. Do të përzgjedhim 2 prej tyre që do caktohen për çështjen nr. 1 dhe nr. 4. Emri i parë është {...}. Emri i dytë është {...}.

Për çështjen nr. 3 për të cilën kërkohet caktimi i një gjyqtari, si i përzgjedhur nga shorti konsiderohet gjyqtari që nuk është caktuar për çështjen nr. 1 dhe nr. 4, që është gjyqtari {...}. Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Apelit Vlorë.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Apelit Durrës**. Gjykata e Apelit Durrës, deri më datë 14 qershor 2019 ka paraqitur nevojë për 5 çështje penale. Edhe në këtë rast duke konsideruar se mekanizmi i skemës së delegimit dhe i transferimit të përkohshëm është i pamundur të zbatohet, kemi propozuar që të zbatohet vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”. Konkretisht kemi propozuar që gjykata nga duhet të përzgjidhen me short gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 5 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Apelit Shkodër, ndërsa numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 5 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 4.

Këtë propozim e kemi bërë në konsideratë të formimit aktual të disa prej çështjeve në nevojë të Gjykatës së Apelit Durrës, që janë formuar nga gjyqtarë që janë caktuar nga Gjykata e Apelit Shkodër. Referuar këtij propozimi, kemi bërë edhe disa propozime sa i përket përjashtimeve nga shorti. Për çështjen nr. 1 të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Shkodër që kanë pengesë ligjore apo janë caktuar për këtë çështje, që janë konkretisht zonja {...}, {...}, {...}, zonja {...} dhe zonja {...}. Po

kështu, për çështjen nr. 1, përjashtohet nga shorti edhe gjyqtari i Gjykatës së Apelit Shkodër që më herët është caktuar në Gjykatën e Apelit Korçë, zonja {...}. Ndërsa për çështjen nr. 2 përjashtohet nga shorti gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Shkodër, që është e caktuar për gjykimin e kësaj çështjeje, që është zonja {...}.

Jeni dakord me këtë propozim?

*(Anëtarët e Këshillit janë të gjithë dakord.)*

Mirë atëherë, për hapat e shortit kemi propozuar që Këshilli të konsiderojë shortin e zhvilluar më datë 19.04.2019, përmes të cilit janë përzgjedhur tre gjyqtarë të apelit Shkodër, të cilët janë ngarkuar në fakt me një numër të kufizuar çështjesh gjyqësore në Gjykatën e Apelit Durrës. Kemi vlerësuar që për ekonomizim të burimeve njerëzore, të tre gjyqtarët që janë caktuar në shortin e datës 19.04., të konsiderohen për t'u caktuar edhe për çështjet që paraqet nevojë Gjykata e Apelit Durrës, si më lart iu referova.

Jeni dakord me këtë propozim?

*(Anëtarët e Këshillit janë të gjithë dakord.)*

Mirë atëherë, gjyqtarët që janë caktuar më herët nga Gjykata e Apelit Shkodër në Gjykatën e Apelit Durrës janë gjyqtarët {...}, {...} dhe {...}.

Nisur nga kjo, për çështjen nr. 5 për të cilën kërkohet caktimi i tre gjyqtarëve, si të përzgjedhur nga shorti, të konsiderohen tre gjyqtarët si më lart të apelit Shkodër, pra {...}, {...} dhe {...}. Në këtë rast shorti zhvillohet vetëm për gjyqtarin relator që caktohet ai që përzgjidhet i pari.. duhet të bëjmë një short mes tre gjyqtarëve {...}, {...} dhe {...}. Përzgjedhim emrin e njërit prej gjyqtarëve që duhet të jetë relatori i çështjes - Është {...}.

Vazhdojmë, për çështjen nr. 3 për të cilën kërkohet caktimi i 2 gjyqtarëve, si të përzgjedhur nga shorti të konsiderohen ata gjyqtarë që nuk janë caktuar si relatorë për çështjen nr. 5, pra i bie që të ngelen dy gjyqtarët {...} dhe {...}.

Për çështjen nr. 2 për të cilën kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, ai të përzgjidhet me short ndërmjet tre gjyqtarëve të caktuar për çështjen nr. 5, duke përjashtuar gjyqtaren {...}, që është caktuar më herët në këtë çështje. Pra do bëjmë një short mes gjyqtarëve {...} dhe {...}. Do përzgjedhim njërin prej tyre – Është {...} që caktohet për çështjen nr. 2.



Vazhdojmë me çështjen nr. 4 për të cilën kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, ai të përzgjidhet me short ndërmjet 3 gjyqtarëve të caktuar për çështjen nr. 5, pra ndërmjet gjyqtarëve {...}, {...} dhe {...}. Do të përzgjedhim një të tjetër prej tyre për çështjen nr. 4 – Është {...}.

Dhe e fundit, për çështjen nr. 1, për të cilën kërkohet caktimi i një gjyqtari, ai të përzgjidhet me short ndërmjet gjyqtarëve të tjerë të Gjykatës së Apelit Shkodër, duke përjashtuar gjyqtarët që kanë pengesë ligjore, që janë caktuar më herët për gjykimin e saj, pra duke përjashtuar gjyqtarët {...}, {...}, {...}, {...} dhe {...}. Nga gjyqtarët e tjerë të Gjykatës së Apelit Shkodër do duhet të zhvillojmë procedurat e shortit. Emrat që mbeten janë {...} dhe {...} – Atëherë, përzgjidhet emri i gjyqtarit {...} që caktohet për çështjen nr. 1. Me kaq mbyllet procedurat e shortit për Gjykatën e Apelit Durrës.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Apelit Shkodër**. Gjykata e Apelit Shkodër deri më datë 14 qershor 2019 ka paraqitur nevojë për 2 çështje penale. Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizmi i skemës së delegimit dhe ai i transferimit të përkohshëm. Kemi propozuar që të zbatohet vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”. Konkretisht kemi propozuar që gjykata nga duhet të përzgjidhen me short gjyqtarët që do caktohen për gjykimin e dy çështjeve gjyqësore të veçanta të jetë Gjykata e Apelit Durrës dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e këtyre 2 çështjeve të jetë 3. Edhe në këtë rast, si në rastin e mëparshëm kemi propozuar që të konsiderohen shortet e hedhura më herët, përmes të cilave gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Durrës janë ngarkuar në gjykata të tjera të apelit. Kemi propozuar që të përjashtohen nga shorti ata që kanë marrë më tepër ngarkesë deri më sot dhe të mbesin për t’u përzgjedhur vetëm gjyqtarët që kanë më pak ngarkesë. Ju bëj të ditur që janë vetëm dy trupa gjykues të Gjykatës së Apelit Durrës, ku një trup gjykues ka marrë ngarkesë më të lartë, në raport me trupin tjetër gjykues dhe kemi propozuar si të përzgjedhur nga shorti të konsiderohen tre gjyqtarët që janë në përbërje të një trupi gjykues që kanë marrë më pak ngarkesë deri më sot nga kjo gjykatë, sa i përket çështjeve të tjera në gjykata të tjera të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë

funksionin në mënyrë të përhershme. Konkretisht është trupi gjykues që përbëhet nga gjyqtarët {...}, {...}, dhe {...}. Jeni dakord me propozimin e bërë?

(Anëtarët e Këshillit janë të gjithë dakord.)

Mirë, atëherë për çështjen nr. 2 për të cilën kërkohet caktimi i 3 gjyqtarëve, si të përzgjedhur nga shorti konsiderohen 3 gjyqtarët si më lart të Gjykatës së Apelit Durrës, gjyqtarët {...}, {...}, dhe {...}. Në këtë rast, procedurat e shortit do të zhvillohen vetëm për përcaktimin e gjyqtarit relator për këtë çështje. Fusim emrat e 3 gjyqtarëve në një enë për të përzgjedhur njërin prej tyre. {...}, {...} dhe {...}. Do përzgjedhim njërin prej tyre që do të jetë si relator - Është {...}.

Për çështjen nr. 1 për të cilën kërkohet caktimi i 2 gjyqtarëve, si të përzgjedhur nga shorti konsiderohen ata gjyqtarë që nuk janë caktuar si relatorë për çështjen nr. 2 - pra gjyqtarët {...} dhe {...}. Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Apelit Shkodër.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Apelit Tiranë**. Gjykata e Apelit Tiranë ka paraqitur nevojë vetëm për 1 çështje gjyqësore që është në lëndë civile. Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm apo i padobishëm zbatimi i mekanizmit të skemës së delegimit apo i transferimit të përkohshëm. Kemi propozuar që të zbatohet vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”. Konkretisht kemi propozuar që gjykata nga duhet të përzgjidhet me short gjyqtari që do caktohet për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Apelit Durrës dhe numri i gjyqtarëve që do të caktohet për gjykimin e kësaj çështjeje të 1, aq sa është në nevojë Gjykata e Apelit Tiranë. Jeni dakord me këtë propozim?

(Anëtarët e Këshillit janë të gjithë dakord.)

Vazhdojmë hedhjen e shortit për emrat e gjyqtarëve duke përjashtuar kryetarin në detyrë të Gjykatës së Apelit Durrës, që është zoti {...}. Do fusim në një enë emrat e të gjithë gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Durrës për të përzgjedhur njërin prej tyre. {...}, {...}, {...}, {...} dhe {...}. Atëherë, përzgjidhet përsëri gjyqtari {...} i cili caktohet

për çështjen për llogari të Gjykatës së Apelit Tiranë. Me kaq mbyllet shorti edhe për Gjykatën e Apelit Tiranë.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Apelit Gjirokastrë**. Gjykata e Apelit Gjirokastrë ka paraqitur nevojë vetëm për 1 çështje penale. Kërkohet caktimi i 1 gjyqtari. Edhe në këtë rast do duhet të zbatohet vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”. Kemi propozuar që gjykata nga duhet të përzgjidhet me short gjyqtari që duhet të caktohet për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Apelit Vlorë dhe numri i gjyqtarëve të jetë 1. Jeni dakord me këtë propozim?

*(Anëtarët e Këshillit janë të gjithë dakord.)*

Kemi propozuar që të përjashtohen nga shorti kryetarja në detyrë e Gjykatës së Apelit Vlorë, zonja {...} dhe gjyqtari i apelit Vlorë që është anëtare e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, zonja {...}. Dakord?

*(Anëtarët e Këshillit janë të gjithë dakord.)*

Atëherë fusim në një enë emrat e gjyqtarëve të tjerë të Gjykatës së Apelit Vlorë, për të përzgjedhur njërin prej tyre. Emri i parë është {...}, i dyti {...}, i treti {...}, i katërti {...}, i pesti {...}, dhe i gjashti {...}. Do të përzgjedhim njërin prej tyre - {...}, e cila caktohet për një çështjeje gjyqësore të veçantë në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë. Mbyllet edhe procedurat e shortit për Gjykatën e Apelit Gjirokastrë.

Vazhdojmë me gjykatat e shkallës së parë. Fillimisht ato nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Tiranë, konkretisht është **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin**, e cila ka paraqitur nevojë në 12 çështje gjyqësore (8 penale dhe 4 civile). Edhe në këtë rast është i pamundur ose i padobishëm zbatimi i skemës së delegimit apo i transferimit të përkohshëm dhe është propozuar zbatimi i vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”. Konkretisht kemi propozuar që gjykata nga duhet të përzgjidhen me short gjyqtarët që do caktohen për gjykimin e 12 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e

këtyre 12 çështjeve të jetë 6. Në këtë rast kemi propozuar përjashtimet nga shorti. Përjashtohet gjyqtarja e seksionit penal që është me leje lindje, zonja {...}. Të përjashtohen gjyqtarët e seksionit penal të çështjeve penale të themelit që janë caktuar më herët për gjykimin e dy apo më tepër çështjeve gjyqësore në gjykata të tjera të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin, zoti {...}, zonja {...}, zoti {...}, zoti {...} dhe zoti {...}. Kemi propozuar të përjashtohen nga shorti, gjyqtari që është përjashtuar nga shorti me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti {...}, për arsye shëndetësore. Po kështu kemi propozuar që të përjashtohen nga shorti për sa i përket çështjeve gjyqësore civile gjyqtarët e seksionit civil të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë që janë caktuar më herët në gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme, që janë zonja {...}, zonja {...}, zonja {...}, zonja {...}, zonja {...} dhe zonja {...} dhe {...}. Jeni dakord me këtë propozim?

*(Anëtarët e Këshillit janë të gjithë dakord.)*

Mirë atëherë, vazhdojmë me procedurat e shortit. Fillimisht për 8 çështjet penale. Për çështjen penale nr. 4 për të cilën kërkohet caktimi i 3 gjyqtarëve, ata të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e seksionit penal të çështjeve penale të themelit, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Duhet të nxjerrim emrat e gjyqtarëve të seksionit penal të çështjeve të themelit, duke përjashtuar ata që u përmendën më lart. Atëherë, referuar informacionit të marrë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në seksionin penal të çështjeve penale të themelit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë bëjnë pjesë këta gjyqtarë: {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...} dhe {...}. Duke hequr ata që u përjashtuan nga shorti më herët, emrat e tjerë do t'i fusim në një enë. {...}, {...}, {...}, {...} dhe {...}. Atëherë për çështjen nr. 4 do të përzgjedhim 3 prej tyre, ku gjyqtari i përzgjedhur i pari do të jetë edhe relatori i çështjes – Emri i parë është {...}, emri i dytë është {...}. Emri i tretë është {...}. Mbaron shorti për çështjen nr. 4.

Vazhdojmë çështjen penale nr. 6, për të cilën kërkohet caktimi i 2 gjyqtarëve, ata të përzgjidhen me short midis 3 gjyqtarëve të seksionit penal të çështjeve penale të themelit të gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të caktuar për gjykimin e çështjes penale nr. 4. Pra 3 emrat e gjyqtarëve që përzgjedhëm më herët, hidhen në një enë: {...}, {...} dhe {...}. Do të përzgjedhim dy prej tyre që do të caktohen për çështjen nr. 6.

Emri i parë është {...}. Emri i dytë është {...}.

Për çështjen penale nr. 5 për të cilën kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, si i përzgjedhur nga shorti konsiderohet gjyqtari i seksionit penal i çështjeve penale të themelit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i cili nuk është caktuar për gjykimin e çështjes penale nr. 6, që është gjyqtarja {...}.

Për çështjet penale nr. 1, nr. 2 dhe nr. 7, për të cilat kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, për secilën nga ato, gjyqtari të përzgjidhet, me short, midis 3 gjyqtarëve të seksionit penal të çështjeve penale të themelit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të caktuar për gjykimin e çështjes penale nr.4, ku gjyqtari i përzgjedhur për çështjen e renditur e para në listë, përjashtohet nga përzgjedhja në çështjen e renditur me mbas në listë. Do të fusim përsëri emrat e 3 gjyqtarëve. Do të përzgjedhim njërin prej tyre për çështjen nr.1. Është {...}. Për çështjen nr. 2 - {...} dhe, për çështjen nr. 7 është emri i gjyqtarit të tretë që është {...}.

Për çështjen penale nr.3 dhe nr.8, për të cilat kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, ai të përzgjidhet, me short, midis 3 gjyqtarëve të seksionit penal të çështjeve penale të themelit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të caktuar për gjykimin e çështjes penale nr.4, ku gjyqtari i përzgjedhur për çështjen e renditur e para ne liste, përjashtohet nga përzgjedhja në çështjen e renditur me mbas në listë. Pra për 3-shin dhe 8-ën do të fusim përsëri emrat e tre gjyqtarëve për të përzgjedhur një gjyqtar për secilën nga ato.

Atëherë për çështjen nr. 3 përzgjidhet gjyqtari {...}, dhe për çështjen nr. 8 përzgjidhet gjyqtarja {...}.

Vazhdojmë shortin për katër çështjet civile për të cilat kërkohet caktimi i një gjyqtari, ai të përzgjedhjet me shortit nga gjyqtarët e seksionit civil të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë duke përjashtuar ato që u përmendën pak më herët. Në seksionin civil të Gjykatës së Rrethit gjyqësor Tiranë bëjnë pjesë këta gjyqtarë: {...}, {...} dhe {...}.

Fusim në një enë emrat e gjyqtarëve duke hequr ata që janë përjashtuar, vazhdojmë: {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...} dhe {...}.

Atëherë u përzgjedh gjyqtari {...}, që caktohet për 4 çështjet civile në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin. Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin.

Kalojmë në procedurat e shortit për **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë**. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë ka paraqitur nevojën për 2 çështje, të dyja janë penale. Edhe në këtë rast është e pamundur ose i padobishëm zbatimi i skemës së delegimit apo i transferimit të përkohshëm të gjyqtarit dhe kemi propozuar që të zbatohet vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Konkretisht kemi propozuar që gjykata nga duhet të përzgjidhen me short gjyqtarët që do caktohen për gjykimin e dy çështjeve gjyqësore të veçanta të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e këtyre dy çështjeve, të jetë 1. Edhe në këtë rast si në rastin e mëparshëm, kemi propozuar që të përjashtohen nga short gjyqtarët, {...} që është me leje lindje, gjyqtarët e seksionit penal që janë caktuar më herët në dy apo më shumë çështje gjyqësore, {...}, {...} {...}, {...} dhe {...}, sikundër përjashtohet nga shorti dhe gjyqtari që do të caktohej në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin, që ishte gjyqtari {...}, sipas procedurës që ndoqëm pak më parë. Jeni dakord?

*(Anëtarët e Këshillit janë të gjithë dakord.)*

Atëherë do të hedhim në një enë gjyqtarët e seksionit penal duke hequr ata që janë përjashtuar. Emrat e tjerë duhet t’i hedhim në një enë: {...}, {...} dhe {...}. Njëri prej tyre do të përzgjidhet për t’u caktuar në dy çështjet që janë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë. Përzgjidhet emri dhe është {...}.

Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë.

Vazhdojmë me procedurat e shortit për **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër**. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër ka paraqitur nevojë në 4 çështje penale. Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm ose i padobishëm zbatimi i skemës së delegimit apo i transferimit të përkohshëm. Kemi propozuar që të zbatohet vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje

gjqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”. Konkretisht kemi propozuar që gjykata nga duhet të zgjidhen me short gjyqtarët që do caktohen me short për gjykimin e 4 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 4 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 2 deri në 3 çështje, në varësi të procedurave të shortit që do të ndiqen më poshtë.

Në këtë rast kemi propozuar që mos të përjashtohet nga shorti kryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat zoti {...}, referuar numrit të kufizuar të gjyqtarëve dhe ngarkesës së ulët të gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, që justifikon pjesëmarrjen në short edhe të kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat. Jeni dakord?

*(Anëtarët e Këshillit janë të gjithë dakord.)*

Mirë atëherë, për çështjen penale nr. 1 dhe nr. 2, për të cilët kërkohet caktimi i dy gjyqtarëve ata të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat. Do të fusim në një enë emrat e gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, që janë {...}, {...} dhe {...}. Do të përzgjedhim për çështjen nr. 1, 1 (2) prej tyre – {...}, gjyqtari i dytë është {...}. Do të bëjmë të njëjtën procedurë edhe për çështjen nr. 2, nga tre gjyqtarë do të përzgjedhim 2 prej tyre.

Emri i parë është {...}. Emri i dytë është {...}.

Për çështjen penale nr. 3 dhe nr. 4, për të cilat kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, si i përzgjedhur nga shoti të konsiderohet gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat i cili nuk është caktuar për çështjen nr. 1 dhe nr. 2, që mbetet të jetë gjyqtari {...}, për çështjen nr. 3 dhe nr. 4 që kërkohet caktimi i 1 gjyqtari. Me kaq mbyllen procedurat e shortit edhe për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, -më falni.

Vazhdojmë atëherë me gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të Gjykatës së Apelit Shkodër, fillimisht për **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë**. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë ka paraqitur nevojë në dy çështje penale. Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm ose i padobishëm zbatimi i skemës së delegimit apo i transferimit të përkohshëm. Kemi propozuar që të zbatohet vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të

përhershme”. Kemi propozuar që gjykata nga duhet të përzgjidhen short gjyqtarët që do caktohen për gjykimin e dy çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe numri i gjyqtarëve që do caktohen për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta të jetë 1. Në këtë rast kemi propozuar që të përjashtohen nga shorti kryetari në detyrë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, zoti {...}, po kështu të përjashtohen shorti gjyqtarët e seksionit penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, të cilët kanë pengesë ligjore për gjykimin e tyre, konkretisht janë zoti {...} dhe {...}. Jeni dakord me këtë propozim?

*(Anëtarët e Këshillit janë të gjithë dakord.)*

Mirë atëherë, vazhdojmë procedurat e shortit. Për çështjen nr. 2 për të cilën kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, ai të përzgjidhet nga gjyqtarët e tjerë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër të seksionit penal, që sipas informacioneve që ka dërguar Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, duke përjashtuar gjyqtarët {...} dhe {...}, mbetet të jetë vetëm gjyqtari {...}, i cili caktohet për të dy çështjet gjyqësore në nevojë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë. Me kaq mbyllet procedurat për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë**. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka paraqitur kërkesë për 2 çështje penale. Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizmi i skemës së delegimit dhe transferimit të përkohshëm është i padobishëm. Kemi propozuar që të zbatohet vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”. Kemi propozuar që gjykata nga duhet të përzgjidhen me short gjyqtarët që do caktohen për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohet për gjykimin e dy çështjeve gjyqësore të veçanta të jetë 2.

Për çështjen nr. 2, për të cilën kërkohet caktimi i 2 gjyqtarëve kemi propozuar të bëjmë procedurat e shortit përmes gjyqtarëve të seksionit penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, duke përjashtuar nga shorti kryetarin në detyrë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, zotin {...} dhe gjyqtarin e seksionit penal që do caktohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë, që më lart ishte zoti {...}. I bie të bëjmë procedurë shorti për dy



gjqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, që praktikisht, referuar informacionit janë vetëm 2: Është zonja {...} dhe {...}, të cilët automatikisht caktohen për çështjen nr. 2.

Do duhet të bëjmë një procedurë shorti vetëm për çështjen nr. 1 për të përzgjedhur njërin prej gjyqtarëve si më lart. Atëherë, për çështjen nr. 1 përzgjidhet gjyqtari {...}. Ndërsa për çështjen nr. 2 janë gjyqtarët {...} dhe {...}. Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë**. Ka paraqitur nevojë vetëm 1 çështje penale. Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizmi i skemës së delegimit, ndërsa është i padobishëm zbatimi i transferimit të përkohshëm i gjyqtarit. Është i zbatueshëm vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, referuar të cilit kemi propozuar që gjykata nga duhet të përzgjidhen me short gjyqtarët që do caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohet për këtë çështje është aq sa është në nevojë kjo gjykatë, pra 1 gjyqtar. Në këtë rast kemi propozuar të përjashtohen nga shorti gjyqtari i transferuar përkohësisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës, zoti {...}, pasi nuk dimë nëse do të vazhdojë të jetë i transferuar përkohësisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës. Kemi propozuar që të mos përjashtohet nga shorti, kryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, zoti {...}, për vetë numrin e kufizuar të gjyqtarëve dhe ngarkesën jo të lartë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës. Jeni dakord me këtë propozim?

*(Anëtarët e Këshillit janë të gjithë dakord.)*

Mirë atëherë, hedhim në një enë emrat e gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës që janë: {...} dhe {...}. Do të përzgjedhim njërin prej tyre që të caktohet për çështjen në nevojë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë.

Është {...}. Me kaq mbyllen edhe procedurat e shortit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë.

Vazhdojmë me gjykatat nën juridiksionin e Gjykatës së Rrethit Gjirokastër, që është vetëm **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet**. Ka paraqitur nevojë vetëm në 2 çështje penale. Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizmi i skemës së delegimit, ndërsa është i padobishëm mekanizmi i transferimit të përkohshëm dhe duhet të zbatohet vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, referuar të cilit kemi propozuar që gjykata nga duhet të përzgjidhen me short gjyqtarët që do caktohen për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohet për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta të jetë 1. Në këtë rast kemi propozuar që të përjashtohen nga shorti vetëm kryetari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, zoti {...}. Jeni dakord?

*(Anëtarët e Këshillit janë të gjithë dakord.)*

Atëherë, hedhim në një enë emrat e gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, që janë {...}, {...} dhe {...}. Do të përzgjedhim njëren prej tyre që të caktohet për 2 çështjet në nevojë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet.

Është {...}.

Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet.

Vazhdojmë me gjykatat nën juridiksionin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, që është vetëm **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec**. Ka paraqitur nevojë vetëm për 1 çështje civile. Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizmi i skemës së delegimit dhe i padobishëm mekanizmi i transferimit të përkohshëm. Do duhet të zbatohet vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, referuar të cilit kemi propozuar që gjykata nga duhet të përzgjidhen me short gjyqtarët që do caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë dhe numri i gjyqtarëve të jetë aq sa është paraqitur nevoja, pra 1 gjyqtar. Në vijim të këtij propozimi kemi propozuar që referuar të dhënave të ofruara nga kryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec në lidhje nga caktimi më parë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr.

35, datë 26.02.2012 (*lapsus viti, pasi është 2019*) të një gjyqtari për gjykimin e kësaj çështjeje gjyqësore për të cilën është një kërkesë e riparaqitur, Këshilli të konsiderojë shortin e bërë më herët që është caktuar gjyqtari për këtë çështje. Është një çështje për të cilën gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë ka vendosur kthimin e akteve dhe është paraqitur përsëri e njëjta padi. Gjyqtari që kemi zgjedhur më herët me short nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë është gjyqtarja {...}. Jeni dakord me këtë propozim?

*(Anëtarët e Këshillit janë të gjithë dakord.)*

Mbyllen procedurat edhe për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec.

Vazhdojmë për gjykatat administrative. Fillimisht për **Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë**, e cila ka paraqitur nevojë në 12 çështje, ku në secilën prej tyre kërkohet 1 gjyqtar. Edhe në këtë rast është e pazbatueshme skema e delegimit, ndërsa është i padobishëm transferimi i përkohshëm i gjyqtarit. Do duhet të zbatohet vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, ku referuar të cilit kemi propozuar që gjykata nga duhet të përzgjidhen me short gjyqtarët që do caktohen për gjykimin e 12 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë dhe numri i gjyqtarëve të jetë 3. Në këtë rast kemi propozuar të përjashtohet nga shorti vetëm kryetari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, zoti {...}. Jeni dakord?

*(Anëtarët e Këshillit janë të gjithë dakord.)*

Mirë atëherë, për hapat e shortit kemi propozuar për çdo grup prej 4 çështjesh, do duhet të zgjedhim 1 gjyqtar të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë. Duhet të bëjmë bashkë 1, 2, 3, 4 bashkë, 5, 6, 7, 8 bashkë, 9, 10, 11, 12 bashkë.

Në një enë tjetër do hedhim emrat e gjyqtarëve të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, që janë: {...}, {...} dhe {...}.

Do të përzgjedhim një nga grupet e çështjeve.

Grupi i çështjeve nga 1-4. Do të përzgjedhim emrin e një gjyqtari – {...}.

Grupi i dytë i çështjeve është – nga 9-12. Do të përzgjedhim emrin e një gjyqtari – që është {...}.

Dhe grupi tjetër i çështjeve që është nga 5-8 – emri i gjyqtarit është {...}.

Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë.

Dhe e fundit është **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë**, e cila ka paraqitur nevojë për 2 çështje, ku kërkohet në secilën prej tyre 1 gjyqtar. Edhe në këtë rast është e pazbatueshme skema e delegimit të gjyqtarit, ndërsa është i padobishëm transferimi i përkohshëm i tij. Do duhet të zbatohet vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, ku referuar të cilit kemi propozuar që gjykata nga duhet të përzgjidhen gjyqtarët që do caktohen për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë dhe numri i gjyqtarëve që do caktohen për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta të jetë 1. Në kuadër të këtij propozimi, kemi propozuar që të përjashtohen nga shorti kryetari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, zoti {...}, po kështu të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë të cilët janë caktuar më herët për gjykimin e më tepër se 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, që referuar të dhënave të mbajtura nga administrata e Këshillit të Lartë Gjyqësor janë këta gjyqtarë: zoti {...}, zonja {...}, zoti {...}, zonja {...}, zonja {...}, zonja {...}, zoti {...}, zonja {...}, zonja {...}, zoti {...}, zoti {...} dhe zonja {...}. Jeni dakord me këtë propozim?

*(Anëtarët e Këshillit janë të gjithë dakord.)*

Dakord. Do duhet të hedhim në një enë emrat e gjyqtarëve të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke përjashtuar emrat e gjyqtarëve që u përjashtuan nga shorti. Gjyqtarët që mbeten janë: gjyqtare {...}, {...} dhe {...}. Do duhet të përzgjedhim njërin prej tyre që do caktohet në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Korçë – {...}.

Me kaq mbyllen procedurat edhe për Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Korçë dhe të gjithë procedurat. Faleminderit!

**Maksim Qoku:** Faleminderit zoti kryetar.

Administrata të marrë masat që të botohen në faqen zyrtare se është për efekt të publikimit të njoftimit, për t'u llogaritur afati i dhënies së pëlqimit për ato vendimet e mëparshme. Nëse nuk ka gjë tjetër, do llogarisim afatin 3-ditor, mbase mund të lejmë një mbledhje për të premtën. Faleminderit! Punë të mbarë!

\* \* \*

(Pika 8 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**